EKSTRAKT I KUSHTEVE TË KONTRATES SË SIGURIMIT
JETA DHE SHËNDETI I STUDENTEVE

Në zbatim të Ligjit Nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" Shoqëria e Sigurimit SiCRED sh.a. dhe Statutit e shoqërisë SiCRED sh.a. paraqesim si vijon ekstrakt të kushteve të Kontratës së Sigurimit.

Kontrata e Sigurimit Jeta dhe Shëndeti i Studenteve është kontrata me anë të së cilës, mbulon Jetën dhe Shëndetin e të Siguruarit, shpenzimet për trajtim mjekësor nëse sëmuret dhe/ose dëmtohet në një aksident, sipas kushteve të përgjithshme deri në kufijtë e përcaktuar në këtë kontratë, gjatë kohëzgjatjes së saj me kusht që Siguruesit SiCRED t'i jetë paguar primi i sigurimit.

1.1 Përcaktime

a) **Shpenzimet mjekësore** që do të mbulohen nga kjo kontratë, do të konsiderohen shpenzimet e kryera për trajtim të specializuar mjekësor në rast dëmtimi aksidental apo sëmundjeje që nuk ka ekzistuar deri apo 2 vjet para hyrjes në fuqi të kontratës;

b) **Dëmshpërblim për Aksidente Personale** sipas kësaj kontrate do të konsiderohet dëmtimi fizik i të Siguruarit, shkaktuar vetëm dhe drejtpërdrejt nga mjete aksidentale të dhunshme, të jashtme e të dukshme (përfshi ndodhjen rastësisht në një fatkeqësi të një mjeti ajror apo ujor në të cilën udhëton personi i siguruar) gjatë periudhës së sigurimit;

c) **Humbje e një gjymtyre** do të thotë këputja fizike e një dore në ose mbi kyçin e dorës, të një këmbe në apo mbi gju;

d) **Humbje e shikimit** do të thotë humbja e plotë dhe e pakthyeshme e shikimit në të dy sytë;

e) **Paaftësi e përhershme e plotë** do të thotë paaftësia e plotë e të Siguruarit për të ndjekur studimet për një vit shkollor;

f) **Shpenzimet për Urgjencat dhe Evakuimin** në rast ndodhje të ndonjë urgjence mjekësore, gjatë së cilës Siguruesi do të paguajë shpenzimet për dhënien e ndihmës së shpejtë dhe evakuimin e të Siguruarit nga vendi ku ka ndodhur sëmundja për në spital.

g) **Shpenzimet e Riatdhesimit** sipas së cilës Siguruesi do të paguajë
   - **I.** për qiranë e një mjeti transporti, të një ambulance ajrore ose përdorimin e linjës së rregullt ajrore, përfshi shoqëruesit e kualifikuar të vërtetuar si të nevojshëm nga mjeku dhe autorizuar nga Siguruesi, për riatdhesimin e një personi të siguruar, të sëmure apo të dëmtuar seriozisht,
   - **II.** Shpenzimet funerale jashtë territorit të Shqipërisë dhe/ose kostoja e transportit të kufomës apo hirit të personit të siguruar, për në vendin e banimit të treguar në policë, nëse ai vdes gjatë periudhës së mbulimit,

1.2 E Drejta për të qenë i Siguruar

a) Kanë të drejtë të sigurohen dhe mbulohen nga kjo kontratë të gjithë shtetasit shqiptarë që ndjekin studimet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
b) Në varësi nga nevojat e të Siguruarit dhe kohëzgjatja e qëndrimit (studimeve) jashtë territorit të Shqipërisë, periudha e mbulimit varion nga 2 javë deri në 6 muaj.

1.3 Përfitimet e Pagueshme

1. Me policën e Sigurimit të Jetës dhe Shëndetit për Studentët që studiojnë jashtë Shqipërisë, mbulohet:
   a) Jeta;
   b) Shpenzimet mjekësore;
   c) Aksidentet Personale;
   d) Urgjenca dhe evakuimi;
   e) Riatdhesimi.

1.4 Përjashtime

Siguruesi nuk është përgjegjës dhe nuk do të paguajë asnjë përfitim në rastet kur:

1. Shpenzimet janë paguar ose do të paguhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Shpenzimet janë bërë nga i Siguruari 30 ditë pas mbarimit të periudhës së sigurimit, ose 30 ditë pas datës së diagnostikimit ose fillimit të trajtimit mjekësor.
3. Bëhet kërkesë për dëmshpërblim dhe kur shpenzimet e ardhura nga defektet fizike, dobësi, gjendje shëndetësore kronike për të cilën i siguruari është konsultuar me ndonjë mjek ose ka marrë trajtim mjekësor, ose sëmundje, kanë ekzistuar deri ose 24 muaj më parë se data e hyrjes në fuqi të policës së sigurimit.
4. Kryhen shpenzime që rrjedhin nga pasojat e ndikimit të ilaçeve ose helmeve të çdo lloji, përdorimi i drogës apo alkoolit, nga vetëvrasjet, nga sëmundjet apo dëmtimi nga vetëinfektimi i qëllimshëm, akte kriminale të të personit të siguruar, vetekspozimi në rreziqet e veçanta (përveç përpjekjeve për të shpëtuar jetë njerëzore).
5. Kryhen shpenzime për mjëkimin e çrregullimeve mendore ose nervore.
6. Kryhen vizitat e zakonshme të syrit dhe jepet ndihma për të shikuarin, vizitat e zakonshme të veshit dhe jepet ndihma për dëgjim, mjekimi i zakonshëm i dhëmbëve, vënia e dhëmbit fals ose protezave.
7. Kryhen ekzaminimet mjekësore ose kontrollet me kërkesë dhe dëshirë të të Siguruarit.
8. Kryhet kirurgji kozmetike fakultative dhe mjekim shoqërues.
9. Kryhen shpenzime për shtatzëni normale dhe kostot e lindjes së fëmijës.
10. Pësohen dëmtime gjatë marrjes pjesë në ngjitje alpinistike, gjatë fluturimit me avion të çdo lloji (përveç rasteve kur udhëton vetëm si pasagjer), gjatë ushtrimit të sporteve dimërore, gjatë garave me kuaj, makina dhe motoçikleta etj.
11. Trajtohen sëmundjet veneriane, AIDS dhe të gjitha sëmundjet e shkaktuara nga dhe/ose lidhur me virusin HIV.
12. Pagesat kalojnë çmimin e arsyeshëm dhe të zakonshëm për shërbimet dhe furnizimet e bëra.
13. Kryhen shpenzime për shkak të luftës (invazionit), luftës civile, pjesëmarrjes në akte terroriste dhe rreziqeve që lidhen me to.
14. Kryhen mjekime në kushte shtëpie, shpenzime, shërbime apo trajtime, të cilat nuk janë rekomanduar, aprovuar dhe konsideruar si të nevojshme nga një mjek, apo shpenzime që nuk janë të një natyre mjekësore.
15. Ndodhin dëmtime apo sëmundje për shkak të infektimit masiv pandemik dhe bioterrorizmit.

1.5 Paraqitja e Dokumentacionit për Trajtim Rast Dëmi

   a. Kopje origjinale e policës së sigurimit;
   b. Dokumentacioni i plotë mjekësor;

c. Raporti i diagnostikimit, përshkrimit të mjekimit, gjendjes së pacientit, raportin përfundimtar mjekësor;
d. Fotokopje e pasaportës, vizës, vulave të hyrjes dhe daljes nga kufiri;
e. Çdo dokument tjetër i nevojshëm për trajtimin e dëmit/eve, i kërkuar nga siguruesi;
f. Kërkesa për dëmshpërblim sipas formularit të përgatitur nga siguruesi, i plotësuar nga i siguruari, trashëgimtari i tij apo nga shfrytëzuesi (përfituesi) i sigurimit;

I. Në rast aksidenti duhet paraqitur edhe:

a. Raporti zyrtar apo vërtetim i dhënë nga autoritetet përkatëse jashtë vendit për aksidentin e ndodhur, rrethanat dhe dëmtimet.

II. Në rast vdekje natyrore duhet të paraqesë:

a. Raportin e diagnostikimit të nevojës urgjente nga sëmundja akute për trajtim mjekësor, të përshkrimit të mjekimit, të gjendjes së pacientit gjatë qëndrimit në spital dhe raportin e autopsisë;
b. Dokumentacionin nga mjeku i familjes dhe/ose enti për sëmundje të konstatuara dhe trajtuara përpara udhëtimit;
c. Çertifikatën e vdekjes;
d. Vendimin e gjykatës për trashëgiminë.

III. Dokumentacioni duhet të paraqitet në origjinal ose fotokopje e noterizuar dhe i përkthyer.

1.6 Taksat dhe Tatimet

a) Taksat dhe tatimet e detyrueshme sipas ligjit janë në ngarkim të Policëmbajtësit dhe/ose të Përfituesve.